

**QASJE KRAHASUESE NË MES VEPRËS *RISALETU’L GUFRA*
(LETRA E FALJES) TË EBUL-ALA EL-MEARRI DHE *DIVINA
COMMEDIA* (KOMEDIA HYJNORE) TË DANTE ALIGHIERIT**

**COMPARATIVE APPROACH BETWEEN THE WORKS *RISALETU’L
GUFRA* (THE EPISTLE OF FORGIVENESS) BY EBU’L-ALA EL-
MEARI AND *DIVINA COMMEDIA* (DIVINE COMEDY) BY DANTE
ALIGHIERI**

Zejni MAZLLAMI¹, Hasan SALIU²

^{1*} Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova

^{2*} Master of Arts in History

*Corresponding author e-mail: zejni.mazllami@unite.edu.mk; hasan.saliu@outlook.com

Abstract

Muhammad's (pbuh) journey to Miraj has become a source of inspiration for numerous Muslim and non-Muslim philosophers, mystics, and authors. A significant number of specifics and topographical outlines of scenes and episodic depictions in the Divine Comedy, the types or analogous models of which did not appear in the various versions of Muhammad's mirage narrative, also have antecedents and models, either akin to or identical in the Qur'an, hadith, or other Islamic literature describing the afterlife.

The work *Risaletu'l Gufran* by Ebu'l-Ala el-Maarri was composed at the beginning of the 11th century, while Dante Alighieri's *Divine Comedy* was created in the latter half of the 13th century. Regardless of the geographical and temporal distances, these two works share numerous meeting points. The issue of Dante Alighieri's influence by Islamic eschatological themes, despite countless literary and historical debates and controversies, remains unresolved. Similarly unresolved is Dante's boldness in incorporating pagan figures and polytheistic elements in the "*Christian masterpiece of the Middle Ages*."

Key words: comparative approach, *Risaletu'l Gufran*, Divine Comedy, religious literature

Abstrakt

Udhëtimi i Muhamedit (a.s) në Miraxh është bërë burim inspirimi i shumë filozofëve, mistikëve dhe letrarëve muslimanë dhe jomuslimanë. Një numër i konsiderueshëm hollësish dhe përvijimesh topografike të skenave dhe përshkrimeve episodike të Komedisë Hyjnore, tipet ose modelet e ngjashme të cilave nuk kishin dalë në redaktimet e ndryshme të tregimit të Miraxhit të Muhamedit (a.s), ka gjithashtu pararendësit dhe modelet, qoftë të ngjashëm, qoftë identikë në Kur'an, hadith apo në literaturë tjetër islame që përshkruajnë jetën e përtejvarrit.

Vepra *Risaletu'l Gufran* e Abu al-a al-Ma'arri është shkruar në fillim të shek. XI, kurse *Komedia Hyjnore* e Dante Alighierit është shkruar në gjysmën e dytë të shek. XIII. Pavarësisht largësisë gjeografike dhe distancës kohore, këto dy vepra kanë shumë pikëtakime. Çështja e ndikimit të Dante Alighierit nga temat eskatologjike islame pavarësisht debateve dhe polemikave të panumërta letrare dhe historike ngelën e hapur, po

aq i pazgjdhshëm ngelën guximi i Dantes që në “*kryeveprën krishtere të mesjetës*” të përdorë figura pagane dhe elemente politeiste.

Fjalët kyçe: qasje krahasuese, Risaletu’l Gufran, Komedia Hyjnore, letërsia fetare.

Poetët

Risaletu’l-Gufran

Në Parajsë janë vendosur shumë poetë, si: Zuhejr, Abid, Adi ibn Zejd, Abu Zuajb al-Huzalijem, an-Nabiga, Amr ibn al-Ahmar, al-A’sha Kajs, Lebid, Nabiga ibn Xhaz, Ash-Samah ibn Dirar, Tamim ibn Ubajji dhe pesë poetë e verbër të fisit Kajs. Prej poetëve me të njohur të periudhës islame përmendet Hasan bin Thabit, i njohur si poeti i Pejgamberit (a.s). Një fakt shumë i rendësishëm dhe ndoshta më kundërthenësi është vendosja në Parajsë e poetëve arabë paraislamë, gjë që nuk ndodh në përzgjedhjen e Dantes në Komedinë Hynore.

Thuajse të gjithë banorët e ferrit të cilët i përmend Al-Ma’arri janë poetë. Personi i parë të cilin e takon Al-Ma’arri në ferr ishte poetesha e njohur arabe Hansa Sulamij. Bashkë me kryedjallin Iblisin, Ibn al-Karih e takon poetin e shquar të letërsisë klasike arabe, Bashar ibn Burd. Gjatë dialogut që zhvillon ibn al-Karrih me Iblisin, ky i fundit i tregon se Bashar ibn Burd ka merita të veçanta te ai. Në ferr heroi i veprës takon poetin Imru’l Kajs, i cili i ankohet se është keqkuptuar dhe keq interpretuar.

Ibn al-Karih në mes të ferrit sheh poetin Antara ibn Shedad të dëshpruar dhe duke vuajtur. Ibn al-Karih, shpreh keqardhje për gjendjen në të cilën ndodhet Antara. Ibn al-Karih bëhet kureshtar dhe pyet për Amr ibn Kulthumin. Ja ku është, mund të flasësh me të nëse dëshiron—i’u përgjigjen rojet e ferrit. Në mesin e poetëve në Ferr, ibn al-Karih dallon Alkam ibn Abd dhe Haris al-Jashkurijem. Në ferr gjendet edhe poeti i madh paraislam Tarafa, i cili është ndëshkuar jo vetëm sepse e ka lavdëruar verën por për arsye se e ka mohuar botën e përjetshme (ahiretin). Prej atyre fatkeqëve që ishin dënuar ishte edhe Kabir al-Huzali. Ibn al-Karrih në ferr takoi Aus ibn Haxhar me të cilin zhvillon një polemikë të shkurtër.

Ibn al-Karrih, takoi një njeri të panjohur që rrënkonte nga dënimi i tmerrshëm. Ai ishte Ahtali, i cili nuk kishte përqafuar islamin dhe kishte dhenë mbështetje të pa rezervë Jezidit. Në polemikën në mes Ahtalit dhe Ibn al-Karih ndërhyu edhe Iblisi. Ibn al-Karih bëzdiset nga pamjet e tmerrshme dhe takimet me poetët e ndëshkuar, prandaj mendon që të largohet. Ndërkohë i kujtohet se nuk i ka takuar dhe ka harruar që të pyes dhe interesohet për fatin e poetëve të njohur, si: Ta’abata Sharan, Shanfara, Muhahil at-Taglibi, Shanfara al-Azdiq etj. Pasi i takon të gjithë dhe sheh vuajtjet e tmerrshme që përjetojnë, Ibn al-Karrih shpreh keqardhje të thellë.

Komedia Hyjnore

Njëri nga pikëdallimet kryesore në mes Risaletu’l Gufran dhe Komedia Hyjnore është, prezenca e poetëve si protagonistë në të parën dhe thuajse mungesa e plotë e poetëve dhe vendi e roli i parëndësishëm i në të dytën. Në Komedinë Hynore krahas Dantes që është protagonist i kësaj poeme dhe Virgjilit që është udhërrëfyes i tij në Ferr dhe Purgator, përmenden poetët e mëdhenj të antikitetit të cilët vetë Dante i takon në Purgator. Poashtu në Purgator përmenden edhe tre poetë, edhe atë: Juvenali, poet satirik romak; Guid Guinçeli, poet “doktrinar” nga Bolonja dhe Sordeli, poet italian i shek. XIII, për të cilin Dante shkruan se ka vdekur nga dhuna.

Është shumë e guximshme që Danteja për udhëheqës të tij në botën e përtejme cakton një poet pagan, Virgjilin dhe poetët tjerë pagan, pavarësisht krijimtarisë së tyre letrare të mbushur me elemente politeiste ua rezervon si vendqëndrim Purgatorin.

Qeveritarët dhe shenjtorët

Risaletu'l-Gufran

Në krahasim me Komedinë Hyjnore ku shenjtorët dhe klerikët jo vetëm që janë të shumtë në numër por zenë vend të veçantë, në veprën Risaletu'l-Gufran, në të tri pjesët, vetëm në Vendprijtje (Purgator) përmenden disa personazhe, kryesisht anëtarë të afërt të familjes së Pejgamberit (a.s), edhe atë: Hamza (xhaxhai), Aliu (dhëndrri), Fatimja (e bija), Hadixhja (gruaja e parë), Muhamedi dhe Zejdi (stërnipërit), Abdullahu, Kasimi dhe Ibrahim (djemtë).

Komedia Hyjnore

Me të drejtë shumë studiues Komedinë Hyjnore e konsiderojnë si një leksikon i rendësishëm sepse në të përmenden aq shumë emra të sundimtarëve, qeveritarëve, feudalëve, klerikëve dhe shenjtorëve. Këto figura të jetës politike, fetare dhe kulturore nuk kanë qenë vetëm bashkëkohës dhe bashkëatdhetarë të Dantes por ato kanë jetuar në kohë dhe vende të ndryshme. Në Ferr, Dante i ka vendosur të gjithë ata njerëz me të cilët ka pasur konflikte gjatë jetës së tij, këtu në rradhë të parë bëjnë pjesë kundërshtarët e tij politik, shumë feudalë dhe princër që kanë qeverisur në pjesë të caktuara të Italisë.

Danteja, mllefin e tij e shpreh edhe ndaj të gjitha figurave të njohura historike, sidomos ato jo të krishterë të cilën kanë bërë tradhëti, krime, gjakderdhje, keqpërdorime dhe kanë mbjellë përçarje ndër njerëz. Në mesin e atyre që sipas botëkuptimit të Dantes kanë bërë përçarje dhe meritojnë ndëshkimin në ferr janë edhe Muhamedi (a.s) dhe Aliu. Njeriu i cili ka bërë krimin më të madh gjatë historisë së njerëzimit është Juda Iskarioti, ai që e tradhëtoi Krishtin, për këtë shkak ai është vendosur në fund të Ferrit. Nga përzgjedhja dhe mllefi i Dantes nuk u kursyen as klerikët e lartë katolikë të kohës.

Në Purgator, Dante i ka vendosur ato qeveritarë që nuk kanë kryer mizori por kanë qenë të shkujdesur. Në këtë grup bëjnë pjesë: Katoni, një burrshtetas romak i kohës së Cezarit; Manfredi, mbret i Napolit dhe Sicilisë, i cili hyri në luftë më papën; Marcelli, armik politik i Cezarit; Nino Viskonti, rival politik i kont Ugolinit; Trajani, perandori romak pagan ndonëse vdiq i papagëzuar; Alberto dela Skala, sundimtar i Veronës; Ugo Kapeti, kont i Parisit; Titi, djal i perandorit romak Vespasian, i cili në vitin 70 dogji Jerusalemin për t'u hakmarrë për Krishtin.

Krahas këtyre qeveritarëve dhe burrshtetasve, në Prugator, Dante ka vendosur edhe disa shenjtorë dhe klerikë, edhe atë: Danielin, profetin hebre; Shën Stefanin, i cili u mbyt nga hebrenjtë duke e mbrojtur fenë e tij të krishterë; abatin e manastirit të Shën Zenos në Veronë dhe Bonifac Fieskin, kryepeshkopin e Ravenës. Në krahasim me dy pjesët tjera të veprës, Parajsa është e mbushur me plot personazhe "*të ndritura*", të cilët sipas Dantes, me meritë shijojnë dhuntitë dhe mirësitë e Parajsës. Në Parajsë, Dante i ka vendosur thujtë të gjitha figurat e rendësishme të historisë së krishterimit.

Nga qeveritarët jo të krishterë për të cilët Dante ka lënë vend në Parajsë janë dy mbretërit hebrenj: Samueli dhe Ezekija. Pozita të larta në parajsë janë të rezervuar edhe për perandorin romak, Konstatinin e Madh, gjatë qeverisjes të së cilit u nënshkrua Edikti i Milanos (313) dhe u organizua Konkili i Nikesë (326). Pavarësisht, se nuk ishte i krishterë, një vend në parajsën e Dantes ishte siguruar edhe për ligjvënësin e Athinës antike, Solonin. Për shkak të përpjekjeve për ta rimëkembur dhe fuqizuar Perandorinë Romake dhe përmes kësaj edhe ta ndihmojë krishterimin, Dante nuk e la jashtë përzgjedhjes së tij, perandorin Justiniani I.

Dante kishte konsideratë të lartë dhe mirënjohje të thellë për luftërat kryqtare prandaj njërin nga organizatorët dhe pjesëmarrësit e kryqëzates së dytë, perandorin gjerman Konradi III e rehatoi në parajsën e tij. Përvoja e hidhur politike e vetë Dantes dhe dëshira e madhe për t'u kthyer si fitues në vendlindjen e tij bëri që Dante të krijoj miqësi dhe të mbaj shpresë në ndihmën e perandorit Henriku VII i Luksenburgut, shumica e biografëve mendojnë se pikërisht

kjo është arsyeja që ai është vendosur në Parajsë. Krahas qeveritarëve të shumtë, Danteja në Parajsë vendosi kishte lenë vend edhe për shumë shenjtorë.

Thuaje të gjithë shenjtorët dhe klerikët që ishin vendosur në parajsë ishin të krishterë. Nga figurat me të rëndësishme do të veçonim: apostujt e njohur të Krishtit; dishepujt e apostujve; Maria Magdalena; Shën Ndou, një shënjtor i krishterë egjiptian; Makari i Aleksandrisë, një prift që themeloi shumë manastire; teologët e medhenj katolikë të shek. XII dhe XIII, Bernardi nga Klervo dhe Alberti i Madh nga Këlni; themeluesin e rendeve kishtare domenikane dhe benediktiane. Nëse hierarkia kishtare e kohës ngeli e pakënaqur nga kjo përzgjedhje e Dantes, për papa Inocentin III ishte lenë një vend në Parajsë.

A është Komedia Hyjnore një vepër e shenjtë krishtere?

Mbi bazën e një ajeti të Kur'anit, në cilin bëhet fjalë mbi udhëtimin e mrekullueshëm të Muhamedit (a.s) dhe disa haditheve të vërtetuara nga muhadithët, në të cilat përshkruhen me një imtësi të madhe detajesh, etapat dhe episodet e këtij udhëtimi, në dy pjesët e tij: vizita në Ferr dhe ngritja në Parajsë. Të gjitha këto rrëfime ishin tashmë të njohura nga masat muslimane të paktën që prej shek. IX. Muhamedi (a.s) është në të gjitha rrëfimet protagonist i udhëtimit dhe në të njëjtën kohë është ai vetë që rrëfen ndodhitë dhe përshkruan vendin.

Të njëjtin pozicion ka edhe Danteja te Komedia Hyjnore. Virgjili i paraqitet Dantes papritmas për t'i shërbyer si udhërrëfyes, me urdhër hyjnor, sikurse Xhibrili i paraqitet Muhamedit (a.s), dhe gjatë gjithë udhëtimit kënaq kureshtitë e udhëtarit. Arkitektura e ferrit dantesk nuk është më shumë se sa një kopje besnike e atij musliman. Sa më e madhe është thellësia aq më i madh është faji dhe aq më e madhe është vuajtja. Së fundi, pikënisja e ferrit në të dy rastet është e njëta: nën qytetin e Jerusalemit.

Një numër i konsiderueshëm hollësish dhe përvijimesh topografike të skenave dhe përshkrimeve episodike të Komedisë Hyjnore, tipet ose modelet e ngjashme të të cilave nuk kishin dalë në redaktimet e ndryshme të tregimit të Miraxhit të Muhamedit (a.s), ka gjithashtu pararendësit dhe modelet, qoftë të ngjashëm (analogë), qoftë identikë në Kur'an, hadith apo në literaturë tjetër islame që përshkruajnë jetën e përtejvarrit. Poashtu në tregimet islame të Gjyqit të Fundit, në doktrinën e teologëve dhe të filozofëve, në mënyrë të veçantë të mistikëve, që sistematizuan, interpretuan dhe arsyetuan të gjitha këto dëshmi.

Nga të gjithë dijetarët muslimanë, Ibn Arabi është më i kapshmi si model i mundshëm imitimi, në atë që ka të bëjë me arkitekturën danteske të përtejvarrit, në të cilën mbizotëron vizatimi i njëjtë sferik. Ibn Arabi, në shek. XIII, njëzet e pesë vjet përpara se të vinte në jetë Dante, lë të botuara në katër fletë të veprës *Futuhât*, vizatime të vendeve të përtejvarrit, të gjitha të frymëzuara në simbolin sferik, që sipas tij përfaqëson kosmosin dhe zanafillën e tij. Nuk duhet harruar se pjesa dërmuese e legjendave të krishtera pararendëse të Komedisë Hyjnore janë të mëvonshme se sa shek. IX, ndërkohë që hadithet islame që flasin për jetën përtejvarrit janë shumë më të hershme se kjo datë.

Përmbledhjet e haditheve eskatologjike qarkullonin në mesin e popullit, si doracakë fetarë për meditim dhe edukim. Ndërgjegjja kolektive e muslimanëve spanjollë, e mbushur me këto ide e përfytyrime që lidheshin me jetën e përtejvarrit, domosdoshmërisht duhet t'i jetë shpalosur edhe popullsisë krishtere që bashkëjetonte me të. Pas gjithë kësaj, kuptohet se sa e natyrshme ishte që të krishterët spanjollë i njihnin hollësisht përvijimet kryesore të jetës së Muhamedit (a.s) dhe për më tepër tregimin e Miraxhit.

Veprat e Dantes e paraqesin qartë mosnjohjen e botës së gjerë dhe të banorëve të saj. Në Komedinë Hyjnore, kurorë e opusit të tij, paraqitjes së ngjarjeve bashkëkohore jashtë Italisë u mungon qartësia dhe saktësia. Jashtë kufijve më të ngushtë të botës së krishterë perëndimore "gjithçka ishte e errët". Sa i përket qëndrimit të Dantes ndaj Islamit, nëse nuk do të ishte në veçanti armiqësor, ai qëndronte ishte përzierje e gjakftohtësisë, mosdijes dhe rezistencës, gjithë kjo buronte nga dëshprimi i Dantes me botën e krishterë.

Mendimi i Dantes shkonte me mendimin e popullarizuar të kritikuesve bashkëkohorë të Kishës, se priftëria e prishur krishtere është fajtoare për ngritjen e Islamit. Por, kjo nuk do të thotë se ai ka thenë diçka të mirë për Islamin. Lufta e Kryqëzatave zë vendin e nderit në Komedinë Hyjnore, duke transmetuar animozitetin e poetit kundër armiqve të botës së krishterë. Dante e dërgoi Bonifacin VIII në Ferr, sepse zhvilloi luftë kundër të krishterëve në shtëpi, në vend që të luftonte kundër muslimanëve dhe hebrejve. Në parajsë do të ishte e kotë të kërkoheshin muslimanët. Mirëpo, në ferr e gjejmë Muhamedin dhe Aliun. Ky dënim i amshueshëm është vendosur për shkak “të mbjelljes përçarjes”. Nuk do të ishte e tepërt të mendohet se në parajsën tokësore të Dantes mos përkatësia krishtere ishte e dënueshme si krim politik.

Marsilio de Padova thaujse terësisht famën ia ka borxh shkrimit *Defensor pacis*, njëres prej shqyrtimeve më të njohura politike mesjetare. Menjëherë pas vdekjes së Marsilios në vitin 1343, papa Klementi VI e gjykoi librin si më heretikun që ndonjëherë ka lexuar. Por, derisa kardinalët romakë njëzëri e gjykuan *Defensor pacis-in*, kjo nuk mund të thuhet për pranimin e librit në shekujt e mëvonshëm. *Defensor pacis* është libër mesjetar. Qëllimi kryesor i librit ka qenë “shkatërrimi i papatit” dhe hudhja poshtë e çdo pretendimi të mundshëm të Kishës për ndonjëfarë të drejte për rregullimin e shoqërisë civile. Antiklerikalizmi i Marsilios nuk guxon të përzihet me shekullarizmin. Ai nuk ka qenë autor antikrishter.

Përfundim

Njëri nga pikëdallimet kryesore në mes *Risaletu'l Gufran* dhe *Komedia Hyjnore* është, prezenca e poetëve si protagonistë në të parën dhe thaujse mungesa e plotë e poetëve dhe vendi e roli i parëndësishëm i në të dytën. Në krahasim me *Komedinë Hyjnore* ku shenjtorët dhe klerikët jo vetëm që janë të shumtë në numër por zenë vend të veçantë, në veprën *Risaletu'l Gufran*, në të tri pjesët, vetëm në Vendqëndrim (Purgator) përmenden disa personazhe. Protagonistë kryesor në *Risaletu'l Gufran* janë poetët arabë kurse në *Komedinë Hyjnore* janë qeveritarët dhe shenjtorët e krishterë.

Sikurse Muhamedi (a.s) në hadithet që përshkruajnë Isranë dhe Miraxhin, edhe Ibn al-Karrih në *Risaletu'l Gufran* është protagonist i udhëtimit dhe në të njëjtën kohë është ai vetë që rrëfen ndodhitë dhe përshkruan vendin ose skenën në të cilën realizohen ngjarjet, të njëtin pozicion ka edhe Danteja te *Komedia Hyjnore*. Një nga arritjet e Dantes ka qenë ndërthurja pa iu dukur vijat e qepjes së portretizimit realist të një realiteti mondan me një sistem universal dhe të përjetshëm të vlerave të krishtera. Muhamedi (a.s) dhe Aliu përmenden në Këngën e XXVII të Ferrit, në vargjet 31-54, janë vendosur prej Dantes në rrethin e tetë të Ferrit, si “mbjellës të përçarjes”. Prej figurave tjera muslimane përmenden Ibn Sina, Ibn Rushd dhe Salahudin el-Ejub, të cilët përmenden në Këngën e IV te Ferrit, ato janë vendosur në Limb.

Referencat

- [1]. 1968 بيروت, صعب دار, الغفران رسالة, المعري العلاء ابو
- [2]. 1995 بيروت, الجيل دار, القديم الأدب – العربي الأدب تاريخ في الجامع, الفاخوري حنا
- [3]. 1983 بيروت, الملايين العلم دار, العباسي العصر في العربي الشعر أمراء, المقدسي أنيس
- [4]. Al-Ma'arri, A. (1979). *Poslanica o oproštenju*, Sarajevo: Svijetlost.
- [5]. Aligeri, D. (1969). *Komedia Hyjnore - Parajsa*, Prishtinë: Rilindja.
- [6]. Aligeri, D. (1969). *Komedia Hyjnore - Purgatori*, Prishtinë: Rilindja.
- [7]. Aligeri, D. (2004). *Komedia Hyjnore - Ferri*, Tiranë: Albas.
- [8]. Mastnak, T. (2012). *Paqja kryqtare*, Shkup: Logos-A.
- [9]. Palacios, M. A. (2004). *Eskatologjia islame në Komedinë Hyjnore*, Shkodër: Averroes.
- [10]. Said, E. (2009), *Orientalizmi*, Shkup: Logos-A.